[Shqiptarja.com]

E mërkurë 13 Shtator 2023 - Përditësimi i fundit 19:20

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJON BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJTË PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PRË E ZEZË SONDAZHE

POP 5

Lajmet me të lexuara & të komentuara sot

1 Bumi! 3-vjeçari e ndjen fuqi e madhe gjatë lojës "Gjarpi" E gjeta ta vakuo në qafë! Njeriu thërrok emrat ne panik, ambulanca ka ar e nguar me to spitu

2 Eri Kukaliari thotë se ka dëshmitarë se AKI bëndonte ngja nji mik i familjes

3 Me propozim të Partisë Socialiste shkarkohet Komandanta e Forcës Ajrore, "Di Pulaj" ja kanë z ëmendësen

4 U var qafën "Lavdërojnë gra e djaloshë sjellje-fare me punë Kulturë, arrestohet 51-vjeçari në Elbasan

5 Për herë të parë në historinë e futbollit, Shqipëria gjakojë me grupet e Champions League

Kronikë

Me 4 mina me telekomandë në makinë, prangoset 51-vjeçari në Vlorë! Dyshohet se do përdoreshin për ngjarje kriminale! Pamje nga arrestimi (VIDEO)

Petrit Ndoji, 51 vjeç, nga Lezha, ishte arrestuar nga policia e Vlorës pasi në kroskotin e makinës me të cilën po udhëtonte ju gjetën dhe sekuestruan 4 mina me telekomandë. Dyshohet se minat do të përdoreshin për ngjarje kriminale

Eksplozivi C4 në makinë, Balla përshëndet operacionin në Vlorë: Grupi kriminal kishte në plan akte të rënda kriminale e terroriste - 13/09/2023 09:52:57

HOROSKOPI

Lajmi i fundit

Kina bëhet shteti i parë që emëron ambasador në Afganistan

13 Shtator, 19:13

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
13 Shtator, 09:28 | Përditësimi: 13 Shtator, 10:09

Share

A A

VLORË- Katër mina me telekomandë, me lëndë eksplozive C4, të programuara për shpërthim në distancë (të pajisura me aparat celular dhe me kapsolla detonatore), janë sekuestruar nga policia e Vlorës.

Në pranga ka rënë Petrit Ndoji, 51-vjeç, banues në Lezhës, të cilit ju gjetën 4 minat në kroskotin e makinës tip 'Ford Fiesta' me të cilën po udhëtonte në rrugën 'Gjergj Kastriot'. Policia ka dyshime se minat do të përdoreshin për kryerjen e ngjarjeve të rënda kriminale. Këto mina u sekuestruan në kuadër të operacionit "Knock Out 3".

Sh.com

LEXO EDHE:
Zjarri në Finiq, dy të moshuara mbesin në 'qjell të hapur' pasi ia dogjën banesat! Kryebashkiaku: Do riparojmë dëmet

Policia ndau pamjet nga momenti i operacionit kur neutralizohet nga forcat blu 51-vjeçari, të cilit i gjetën të fshehura lëndët eksplozive.

> *Shënbirimet e Policisë, në rrugën "Gjergj Kastriot", ndaluan automjetin tip "Ford Fiesta", që drejtonte i arrestuari. Gjatë kontrollit të imtësishëm, në kroskotin e këtij automjeti, u gjetën dhe sekuestruan me cilësimë e provës materiale, 4 mina me telekomandë, me lëndë eksplozive C4, të programuara për shpërthim në distancë (të pajisura me aparat celular dhe me kapsolla detonatore), të cilat dyshohet se do të përdoreshin për kryerjen e ngjarjeve të rënda kriminale.' -njofton policia.*

Më ***10 gusht në pranga*** të policisë në kuadër të një operacioni të ngjashëm, po në Vlorë, u arrestua shaxhai bashkë me nipin të cilët kishin dy mina me telekomandë me vete brenda në makinë.

Policia arrestoi Fatjon dhe Ergys Gjonaj, 33 dhe 19 vjeç, banues të Laçi, të cilëve ju gjetën në kroskotin e makinës dy minat me telekomandë. Këto mina ishin të programuara për shpërthim në distancë dhe sipas policisë dyshohet se do të përdoreshin për kryerjen e ngjarjeve të rënda kriminale dhe ishin të pajisura me aparat celular dhe me kapsolla detonatorë për shpërthim. Këto mina u sekuestruan në kuadër të operacionit "Knock Out 2".

Ndërsa në kuadër të ***operacionit 'Knock Out'*** në shkurt të këtij viti prangosën Bledar Ukshini, 31-vjeç dhe Ardit Qamluku, 21-vjeç, të arrestuar po nga policia e Vlorës, pasi u kapën me 3 mina me telekomandë, të montuara me lëndë të dyshuar eksplozive plastike C4, të lidhura me aparat celular, për t'u komanduar në distancë.

Sipas policisë dyshohet se 2 të rinjtë, që u prangosën në një lokal, në lagjen "28 Nëntori", në bashkëpunim me njërin tjetrin, do t'i shisnin minat, për llogari të një grupi kriminal, kundrejt çmimit 10 000 euro.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:16

Dy furgona i prenë rrugën, momenti i arrestimit të 51-vjeçarit në Vlorë që kishte mbushur makinën me mina! Efektivët të armatosur e prangosin

Policia ka publikuar pamjet e arrestimit të 51-vjeçarit Petrit Ndoji në Vlorë, pasi ju gjetën në automjetin ku udhëtonte 4 mina me telekomandë me eksplozivi C4. Sic, shihet në video-dy furgona i prenë rrugën makinës ku udhëtonte 51-vjeçari nga Lezha dhe nga aty dalin efektivë të armatosur.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:49

Eksplozivi C4 në makinë, Balla përshëndet operacionin në Vlorë: Grupi kriminal kishte në plan akte të rënda kriminale e terroriste

Ministri i Brendshëm Taulant Balla përshëndeti aksionin e suksesshëm të strukturave të policisë së Vlorës, të cilat neutralizuan një grup të rrezikshëm kriminal, *"i cili dyshohet se kishte në plan akte të rënda kriminale dhe terroriste, përmes përdorimit të lëndëve plasëse"*

Gjatë aksionit të policisë u sekuestruan disa mina me telekomandë dhe një shtetas u arrestua gjatë këtij aksioni, pasi kishte vendosur eksplozivi C4 poshtë një makine.

Ministri Balla ka përshëndetur menjëherë strukturat e policisë së Vlorës me atë në një postimi në Facebook:

> *"Policia e Shtetit ka goditur një grup kriminal me mezikshmëri të larti, duke parandaluar kërshtu ngjarje të rënda kriminale dhe terrori, për shkak të përdorimit të lëndëve plasëse".*

Gjithashtu Ministri Balla ka vlerësuar angazhimin e strukturave të policisë së Vlorës, në parandalimin, zbulimin dhe neutralizimin e akteve kriminale dhe për kapjen e autorëve të tyre.

> *"Kam besim se Policia e Vlorës do të bëjë detyrën edhe në zbardhjen e ngjarjeve të tjera kriminale të një dite më parë si edhe për vendosjen para drejtësisë të personave të dyshuar,"* – shprehet Ministri i Brendshëm në statusin e tij përgëzues për policinë e Vlorës.

Balla thekson gjithashtu se "qytetarët presin më shumë prej nesh", duke nënkuptuar angazhimin e të gjitha strukturave të tjera në luftën kundër fenomeneve të krimit në vend.

S.G./Shqiptarja.com

Share

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: mina me telekomandë Vlorë petrit ndoji grupi kriminal

Komente

Mbulo diellin me shoshe: 13/09/2023 11:15
Pse kan dal zera qe keto operacione e kan zanafillen ndryshe, nje mik nga nikla thot se drejtuesit ne vlor fusin spiunin per te bler mina dhe e kapin po vet per te ber shou. Gojet e tiga flasin mos harro

Polo: 13/09/2023 10:38
Bravo ouna , zoti minister ne lefra marrin 1milion lek ATO policr.por realisht 58mij lek esht mroa QE cojn ne shpi. sektori me I papague esht marn me Pak lek se policisa e rendit

LORA: 13/09/2023 10:02
Qenka nis lechjani ne Vlore, me urdher te qofteargut.per terror. Respekt per rezultatin e punes se policise.

Pordhicia: 13/09/2023 10:01
Keta zgjedsat e komasirati vlore slan me zonashi pa kapur me spuna qe i sjellin per shtije minash bashkpunitoret e letyre letrave dhe e bejn si operacion .rparicion qohet keur kapni ne flagranc shitsin dhe bleresin jo vegem shitsat idiota

Lani: 13/09/2023 11:31
Ti polici e korupto po pse si lini kush doi i bërtë dhe ti kapësh maskarenj e minister shkrenc policone e vlores nga polici me I thjeshtë e tok me I larti te kesh rezultat . Beje kur e kish sokol mulisonari qe gjithe gangsti u bene spuna

Ndalohet mepërdashit ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A duhen arrestuar personat që kultivojnë kanabis për përdorim vetjak?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Asnjë student i regjistruar! Mbyllet dega e Kimisë, Fizikës dhe Italishtes në Universitetin e Vlorës! Në rrezik Matematika

Armand Xhelili

12 Shtator, 16:17

Siguria në plazhe, bllokohen 11 mjete lundruese nga Ksamili në Velipojë, gjobiten me nga 10 mijë lekë drejtuesit

12 Shtator, 16:14

Zjarri në Livinë të Finiqit, flakët vihen nën kontrollë! Një ditë më parë u dogjën 3 shtëpi, ullishte dhe bimësi

12 Shtator, 09:24

VIDEO/ Vjon zjarri në Livinë të Finiqit! Në mesditë u dogjën 3 banesa! Prefekti Mamaj: Flakët nën kontrollë, po punojmë për shuarjen

11 Shtator, 13:29

EMRAT/ U kapën duke u shitur drogë turistëve në një festival në Dhërmi, me pranga 1 gjerman dhe 3 shqiptarë nga Kosova (VIDEO)

11 Shtator, 12:35

Vrasja e Laertjad Kekajt në Vlorë, autorët e përpalasën me makinë teksa ecte me motor dhe pastaj qëlluan ndaj tij! Plumba edhe në godinën e Bibliotekës

Armand Xhelili

11 Shtator, 11:36

Vlorë, viti i ri shkollor nis me mbi 110 nxënës më pak! Dy shkolla do i nënshtrohen rikonstruksionit

11 Shtator, 11:20

VIDEO/ Atentati në Vlorë, momenti kur Laertjad Kekaj vrapon t'u ikë ekzekutorëve! Audi kthehet e qëllon sërish

10 Shtator, 14:34

Me mijëra të huaj vizitojnë qytetin antik të Butrintit! Turistët e mahnitur: Vendi më i bukur në Shqipëri

Limos Didani

10 Shtator, 13:00

Kultivuan kanabis në Lukovë, 2 të arrestuar, 2 në hetim dhe 1 në kërkim! VIDEO Teksa kujdesesh për lëndët narkotike

10 Shtator, 11:22

Atentati në Vlorë/ Laertjad Kekaj u ekzekutua me 6 plumba në kokë e trup! U qëllua me kallashnikov e pistoletë me silenciator! 28 gëzhoja në vendngjarje

Armand Xhelili

10 Shtator, 07:00

Atentat në Vlorë, qëllohet për vdekje nga një mjet me targa italiane 41-vjeçari! I dënuar më parë për bashkëpunim me një vrasje (EMRI)

9 Shtator, 21:53

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje